

Rezultatet e Anketës së Produkteve Industriale - PRODCOM

Viti 2023

Tiranë, më 26 Shtator 2024: INSTAT publikon të dhënat e Anketës së Produkteve Industriale (PRODCOM) sipas Listës së Produkteve Industriale në nivel të detajuar 8-shifror, e cila përdoret në vendet e Bashkimit Evropian. Vrojtimi mbi produktet industriale kryhet me frekuencë vjetore pranë ndërmarrjeve të industrisë nxjerrëse dhe përpunuese dhe ka si qëllim të ofrojë informacion mbi prodhimin dhe shitjen e produkteve industriale të realizuara nga ndërmarrjet që kryejnë aktivitetin e tyre ekonomik në vendin tonë. Këto statistika të bazuara në këtë vrojtim, shërbejnë për të kryer analiza të detajuara të produkteve industriale të prodhuara në vend.

Prodhimi dhe shitja e produkteve kryesore industriale

Gjatë vitit 2023 është prodhuar 891.400 ton naftë. Prodhimi i hekurit bruto, çelikut dhe formave të tjera primare në vitin 2023 u vlerësua 474.444 ton. Gjatë vitit 2023 është prodhuar 822.206 ton xeherorë dhe koncentrate të kromit dhe 2.176.865 ton çimento.

Prodhimi i grupit të produkteve të pijeve jo alkoolike dhe ujë mineral dhe i gazuar u vlerësua 498.762.537 litra, duke u rritur me 15,9 %, krahasuar me vitin e kaluar.

Tab.1 Sasia dhe vlera e produkteve industriale, 2022-2023

Kodi	Produkti	Njesia matese	2022		2023	
			Sasia e prodhuar	Vlera e shitjeve (milionë lekë)	Sasia e prodhuar	Vlera e shitjeve (milionë lekë)
6101000	Naftë bruto	ton	902.064	44.893	891.400	39.280
24101100	Hekur bruto, çelik dhe forma të tjera primare	ton	508.485	36.462	474.444	33.116
7291910	Xeherorë dhe koncentrate kromi	ton	1.399.017	30.963	822.206	20.359
23511210	Çimento Portland + Çimento të tjera	ton	1.589.298	13.488	2.176.865	19.387
23631000	Beton i gatshëm për përdorim	ton	1.930.593	13.016	1.776.111	13.363
29311000	Sisteme fijesh elektrike të izoluar për përdorim në automjete	mln copë	208.411	7.482	229.973	8.256
10131461	Salçice dhe produkte të ngjashme me mish	ton	10.925	7.390	11.372	8.200
11071950	Pije joalkoolike	litër	114.246.310	6.496	120.857.410	6.926
15201351	Këpucë për burra me pjesën e sipërme prej lëkure	palë	9.192.631	6.724	8.926.473	6.695
11071130	Ujë mineral dhe ujë i gazuar	litër	316.082.892	5.229	382.672.267	6.295

Shënim: Produktet industriale në nivel 8-shifror jo domosdoshmërisht përfaqësojnë sasinë e produkteve industriale të prodhuar në nivel aktiviteti ekonomik


Për publikim 26/09/2024

Vijon

Vlera e shitjeve për produktin naftë gjatë vitit 2023 ishte 39.280 milionë lekë. Vlera e shitjeve për produktin hekur bruto dhe çelik gjatë vitit 2023 ishte 33.116 milionë lekë. Vlera e shitjeve për produktin xeherorë dhe koncentrate të kromit gjatë vitit 2023 ishte 20.359 milionë lekë. Vlera e shitjeve për produktin çimento portland dhe çimento të tjera gjatë vitit 2023 ishte 19.387 milionë lekë.

Vlera e shitjeve për grupin e produkteve të pijeve jo alkoolike dhe ujë mineral dhe i gazuar është gjatë vitit 2023 ishte 13.221 milionë lekë duke u rritur me 12,8 %, krahasuar me vitin e kaluar.


Fig.1 Vlera e shitjeve të produkteve industriale, 2022-2023



Gjatë vitit 2023 metalurgjia zuri 13,5 % të vlerës së shitjeve gjithsej të produkteve industriale nga 15,2 % që zinte në vitin 2022. Përpunimi i produkteve ushqimore zuri 11,7 % të shitjeve gjithsej gjatë vitit 2023 nga 11,4 % që zinte në vitin 2022, ndërsa nxjerrja e naftës bruto zuri 10,5 % të shitjeve gjithsej gjatë vitit 2022 nga 11,2 % që zinte në vitin 2022.

Në figurën e mëposhtme paraqitet vlera e produkteve industriale të shitura, sipas ndarjeve të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike Rev.2 (NVE Rev. 2).

Fig.2. Vlera e shitjeve të produkteve industriale, sipas ndarjes së aktiviteteve ekonomike



Ndarja e aktiviteteve ekonomike sipas NVE Rev.2

- 06 - Nxjerrja e naftës bruto
- 07 - Nxjerrja e mineraleve metalore
- 08 - Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat
- 10 - Përpunimi i produkteve ushqimore
- 11 - Prodhimi i pijeve
- 12 - Prodhimi i produkteve të duhanit
- 13 - Përpunimi i tekstilëve
- 14 - Konfeksionimi i veshjeve
- 15 - Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure
- 16 - Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve
- 17 - Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letrë
- 18 - Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara
- 20 - Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike
- 21 - Përpunimi i produkteve farmaceutike dhe preparateve farmaceutike
- 22 - Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës
- 23 - Prodhimi i produkteve minerale jo metalike
- 24 - Metalurgjia
- 25 - Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve
- 26 - Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterik
- 27 - Prodhimi i pajisjeve elektrike
- 28 - Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t
- 29 - Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove
- 30 - Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit
- 31 - Prodhimi i mobiljeve
- 32 - Industri të tjera p.k.t
- 33 - Ripatimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve

Metodologjia

Anketa e Produkteve Industriale (PRODCOM) është një anketë vjetore, qëllimi i së cilës është mbledhja dhe shpërndarja e statistikave mbi prodhimin dhe shitjen e produkteve industriale të realizuara nga ndërmarrjet në Republikën e Shqipërisë. Termi produkt industrial i referohet si produkteve që kanë dimension fizik ashtu dhe shërbimeve industriale.

PRODCOM mbulon seksionin e Industrisë nxjerrëse dhe Industrisë përpunuese, përkatësisht seksionet B dhe C (NVE Rev. 2). Ky vrojtim bazohet në një klasifikim statistikor (Lista Prodcum) që përmban rreth 4000 lloje të ndryshme të produkteve. Lista Prodcum është e detajuar në nivel 8-shifror dhe përdoret në vendet e Bashkimit Evropian. Produktet industriale në nivel 8-shifror jo domosdoshmërisht përfaqësojnë sasinë e produkteve industriale të prodhuar në nivel aktiviteti ekonomik.

Rezultatet e produkteve industriale në mënyrë që të jenë të përshtatshme me ato të vendeve evropiane realizohen duke zbatuar Rregulloret e Komisionit Evropian:

- Rregulloren e BE-së 2019/2152 mbi statistikat evropiane të biznesit (rregullorja EBS);
- Rregullen zbatuese 2020/1197 që përcakton specifikimet dhe marrëveshjet teknike (akti i përgjithshëm zbatues).
- Lista Prodcum e cila është krijuar nëpërmjet një Rregulloreje të veçantë Zbatuese.

Përkufizimet kryesore të treguesve bazë:

Sasia e prodhuar e produktit (në njësinë matëse të përcaktuar në Listën Prodcum) i referohet prodhimit të realizuar nga ndërmarrjet gjatë vitit referencë.

Sasia e shitur e produktit (në njësinë matëse të përcaktuar në Listën Prodcum) i referohet prodhimit të bërë nga ndërmarrjet gjatë një periudhe kohore të caktuar dhe që është shitur në vitin referencë, pavarësisht nga koha e prodhimit.

Vlera e shitjeve i referohet shumës së faturuar nga shitja e produkteve industriale gjatë vitit referencë, duke përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar.

Bazuar në Politikën e Revizionimit Statistikor të INSTAT dhe Rregullores Zbatuese 2020/1197, të dhënat për vitin e kaluar janë përditësuar si pasojë e burimeve të reja administrative dhe vrojtimit të kryer gjatë vitin 2023.